



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 734/11 prot.

Datë 23.04.2025

V E N D I M

Nr. 543/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergji Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 427/2025, datë 01.04.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 17.02.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F. me NIPT K71707007Q dhe adresë: Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Sh.A.
Adresa: “Rruga: “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

nr.766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave
“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”* .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 01.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.427/2025, ku vendosi:
[...]

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.01.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësim të ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Ervin Luzi” P.F. në përputhje me konstatimet në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” P.F..*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1.2 Me shkresën nr. 245/20 prot., datë 10.04.2025, protokolluar me tonën nr. 734/8 prot., datë 11.04.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 427/2025, datë 01.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.01.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 245/20 prot., datë 10.04.2025, protokolluar me tonën nr. 734/8 prot., datë 11.04.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 427/2025, datë 01.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë

monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.01.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ervin Luzi”P.F., në përputhje me vendimin Nr. 427/2025, datë 01.04.2025 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.01.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

